



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 13, datë 18.01.2024

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 390, DATË 22.09.2021
“PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES, PËR NGRITJEN NË
DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS
PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 129, DATË 01.04.2021, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pika 1 dhe nenin 86, shkronja “ë”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr. 390, datë 22.09.2023 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, vendimin nr. 25, datë 17.01.2022 “Për ndryshimin e vendimit nr. 390, datë 22.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, vendimin nr. 738, datë 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Dritan Hallunaj”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 390, datë 22.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si më poshtë:

Caktimin e z. {...}, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR